



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201800433/10**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda:**            **Rekomandim për rastin e shkollës së mesme të përgjithshme "Partizani".**

**Drejtuar:**        **Znj. Arjola BYZYKA**  
**Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë**

**Znj. Luiza MUSTAJ**  
**Drejtor i Shkollës së Mesme "Partizani" Tiranë**

**Për dijeni:**     **Znj. Lindita Nikolla**  
**Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

**Znj. Erinda Ibrahimllari**  
**Organizata Alo 116**  
**Case Manager/ Menaxhere rasti**  
**Albanian National Child Helpline**  
**Adresa: Kutia Postare 1738, Rruga: "Perlat Rexhepi", Pallati ANA,**  
**Ap. 17,**

**TIRANË**

**Të nderuar,**

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të attributeve që i jepen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ankesës së përcjellë nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), ALO 116, shkresës nr. K5/NJ1-4, datë 1.3.2018, me anë të së cilës është ngritur grupi multidisiplinar i punës, i përbërë nga ekspertë të institucionit, ka kryer një hetim të pavarur administrativ, në shkollën e mesme të përgjithshme "Partizani", Tiranë.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit multidisiplinar të punës, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

## **Shënimet paraprake**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në datën 26.2.2018, është përcjellë një shkresë nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), ALO 116, ku bëhet fjalë për ankesën e fëmijës me inicialet A.K, 16 vjeç, nxënës i shkollës së mesme të përgjithshme “Partizani”, Tiranë dhe prindit të tij A. K., ndaj mësueses së fizikës së kësaj shkolle, znj. Lindita Kapollari. Sipas ankesës së tij, nxënësi dhe prindi ankohen për sjelljen jo etike të mësueses ndaj fëmijës, ku mësuesja e ka sulmuar verbalisht atë, duke vepruar ashpër dhe në mënyrë konfliktuale ndaj nxënësit. Kjo situatë, sipas tyre, vazhdon që nga fillimi i vitit shkollor, ndërkohë që fëmija ka marrëdhënie të mira dhe rezultate pozitive me mësuesit e tjerë.

Gjithashtu, në këtë shkresë të përcjellë nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), ALO 116, shprehet shqetësimi, se konflikti me mësuesen është i përsëritur, pasi gjatë muajit dhjetor 2017 pranë kësaj organizate janë ankuar tri nxënës të kësaj shkolle, në lidhje me sjelljen konfliktuale të mësueses në fjalë dhe përplasjet që janë shkaktuar me nxënësit.

Në po këtë shkresë, është shprehur shqetësimi, se në shkollën e mesme të përgjithshme “Partizani” shërbimi psiko-social ka pothuajse një vit që nuk është i mbuluar si shërbim, shërbim i cili është detyrim ligjor për t’u përmbushur.

## **Hetimi i pavarur administrativ**

Avokati i Popullit, pasi është njohur me ankesën në fjalë, me shkresën nr. K5/NJ1-4, datë 1.3.2018, ka ngritur grupin multidisiplinar të punës, të përbërë nga ekspertë të institucionit, për të kryer një hetim të plotë e të pavarur administrativ për çështjen në fjalë, në përbërje të të cilit kishte jurist, punonjës social dhe psikolog.

Pas ngritje së grupit të punës, në datën 1.3.2018, ekspertët kanë zhvilluar një takim me drejtorin e shkollës së mesme të përgjithshme “Partizani”.

Në kuadër të hetimit administrative janë dërguar dy shkresa me lëndë “Kërkesë për shpjegime” kësaj drejtorie dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale të qytetit Tiranë, për të cilat na është kthyer përgjigje, së bashku me dokumentacionin përkatës, të disponuar për çështjen.

Gjithashtu, nga ana jonë, në datën 23.3.2018, me anë të një njoftimi paraprak, për mos të penguar edhe procesin mësimor në shkollën e mesme të përgjithshme “Partizani”, është zhvilluar një takim në lidhje me ankesat dhe situatën e krijuar mësuesja e fizikës, znj. Lindita Kapollari, me të cilën u mbajt procesverbali i dhënies së shpjegimeve, i firmosur nga grupi i ekspertëve dhe mësuesja, znj. Kapollari.

Për të kryer një hetim sa më të plotë e gjithëpërfshirës, në datën 4.4.2018, pranë mjediseve të shkollës së mesme të përgjithshme “Partizani”, po me anë të një njoftimi paraprak të fëmijëve që ankohen ndaj mësueses dhe prindërve të tyre, janë marrë shpjegime nga fëmija A. K. dhe babai i tij A.K., të mbajtura me procesverbal, ku ka firmosur prindi A.K.,. Për fëmijën tjetër, ankesa e të cilës na është paraqitur nëpërmjet dokumentave të tjera të depozituara nga shkolla e mesme e përgjithshme “Partizani”, kemi kryer një bisedë me nxënësen F.B. në prani të prindit të saj, mësues i kësaj shkolle.

Gjithashtu grupi i ekspertëve në përfundim të hetimit, po në datën 4.4.2018, kontaktoi dhe bisedoi përsëri me mësuese znj. Lindita Kapollari.

Nga gjithë hetimi i kryer më shkollën e Mesme të përgjithshme “Partizani”, rezultoi se: Nga intervistimi i mësueses, znj. Lindita Kapollari në datën 23.3.2018 dhe në datën 4.4.2018, rezultoi se me fëmijën A.K. ka patur dy incidente.

I pari, ka qenë kur e ka ngritur një ditë në mësim dhe fëmija i ka mbajtur duart “në xhepa” dhe, kur nga mësuesja i është kërkuar t’i heqë duart nga xhepat, reagimi i nxënësit ka qenë negativ. Mësuesja në përfundim të mësimin, i ka kërkuar nxënësit ardhjen e prindit, mundësisht nënës në shkollë dhe e ka shoqëruar djalin në zyrën e zëvendës drejtoreshës, ku kjo e fundit është përpjekur t’a qetësojë situatën dhe çështja të mos ndiqej më tej, edhe pse sipas mësueses nxënësi vazhdonte t’i mbante duart si në klasë, pa më të voglin ndryshim. Të nesërmen, është paraqitur babai i fëmijës, z. A.K., dhe ka kontaktuar me mësuesen, ku i ka thënë se i kishte fyer fëmijën një ditë më parë. Përgjigja e mësueses është se, kur i ka thënë fëmijës “...hiqi duar nga xhepat...” dhe fëmija ka refuzuar, mësuesja i ka thënë “...qëndro kështu para sat’ëme...”. Sipas pretendimeve të mësueses, në përfundim të bisedës, prindi i ka kërkuar që brenda mundësive t’a ndihmojë djalin në lëndën e fizikës, pasi ka mungesa nga sistemi 9-vjeçar.

Sipas pretendimeve të mësueses, incidenti i dytë ka ndodhur në përfundim të një ore mësimi, ku mësuesja ju ka kërkuar nxënësve të ndodhur në derën e klasës të kalojnë, ku një prej tyre ishte dhe nxënësi A.K. por ky i është përgjigjur “...s’dua...” dhe “...çfarë do më bësh...”, fjalë të shoqëruara me hapje krahu nga ana e nxënësit. Përsëri, mësuesja e ka shoqëruar fëmijën në zyrën e zëvendës drejtoreshës së shkollës por situata nuk ka marrë zgjidhje dhe më pas, në fund të ditës, mësuesja ka shkuar te drejtoresha e shkollës dhe ka raportuar incidentin, ku kjo e fundit është shprehur se situata është shumë e rëndë. Të nesërmen në zyrën e drejtoreshës janë paraqitur edhe nëndrejtoresha me mësuesin kujdestar. Nga biseda e zhvilluar aty, del që pretendimet e mësueses nuk qëndrojnë, por i jepet të drejtë nxënësit. Duke mos gjetur zgjidhje në shkollë, nga ana e saj është dërguar *e-mail* për ngjarjet në ministri dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë.

Nga ana tjetër fëmija/nxënësi së bashku me prindin kanë bërë ankim pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë për sjelljen agresive, jo-etike të mësueses, për presionin psikologjik që po i bëhet fëmijës nga ana e saj. Theksojmë, se prindi A.K., së bashku me fëmijën i janë drejtuar edhe “Alo 116” me ankesë për mësuesen në fjalë, ankesë e cila ka vënë në lëvizje ne si institucion.

Drejtorja e shkollës së mesme të përgjithshme “Partizani”, bazuar në shkresën e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, nr. 4158, datë 24.11.2017, në të cilën referohet ankesa e z. A.K., për rastin e fëmijës së tij A.K si dhe pas ankesës së nxënëses F.B, (për presionin psikologjik që ka ushtruar mësuesja e fizikës ndaj kësaj nxënëseje në olimpiadën e fizikës), ka ngritur komisionin e disiplinës, në datën 12.12.2017 dhe në datën 14.12.2017, pasi mësuesja nuk u paraqit në datën e mëparshme.

Nga intervista me mësuesen rezultoi, se ajo nuk u paraqit në komisionin e disiplinës dhe e kundërshtoi atë me *e-mail* për kohën shumë të shkurtër midis njoftimit dhe seancës, si dhe për arsyen se në njoftimin për paraqitjen në komisionin e disiplinës nuk i ishin vënë në dispozicion arsyet dhe dokumentacioni bashkëlidhur, ankesat për të cilin ajo duhej të paraqitej në komision.

Komisioni i disiplinës, me vendimin nr.193, datë 14.12.2017, në zbatim të nenit 105, të kreut XIX, të urdhrin nr.343, datë 19.8.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, ka dhënë masën disiplinore ndaj mësueses, znj. Kapollari “Paralajmërim për largim nga puna”, me arsyetimin: “Shkelje e etikës në institucion dhe shkelje e rregullores së olimpiadës, në bazë të ankesës së nxënës F.B. Kjo masë znj. Kapollari i është komunikuar me shkresën nr.194, datë 14.12.2017, të drejtorit të kësaj shkolle.

Nga hetimi administrativ dhe dokumentacioni shkresor i mbledhur nga ana e grupit të ekspertëve, vërehet se situata është komplekse dhe se një sërë institucioneve janë përfshirë për t’i dhënë asaj një zgjidhje ligjore.

Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se Inspektorati Shtetëror Arsimor, ka kryer një inspektim në shkollën e mesme të përgjithshme “Partizani”, në bazë të një sërë ankesash të bëra nga prindërit, drejtuar ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndaj mësueses në fjalë. Ky institucion, në përfundim të inspektimit, ka rekomanduar:

- Drejtoria e gjimnazit “Partizani” të bashkëpunojë me DAR, për ofrimin e shërbimit të psikologut në shkollë, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e dhunës psikologjike dhe respektimin e Kodit të Etikës në institucion.
- Drejtoria e gjimnazit “Partizani”, mbështetur në rezultatet e pyetësorëve të zhvilluar me 100 nxënës të klasave të 11-ta, ku 32% e nxënësve pohojnë se dhunohen psikologjikisht nga mësuesit, të evidentojë dhe analizojë menjëherë gjendjen e dhunës në shkollë dhe të marrë masa konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar hetimin administrativ e konkretisht, në datën 4.4.2018, nga ana e grupit të ekspertëve u morën shpjegime nga nxënësi i kësaj shkolle, me inicialet A.K., në prani të prindit të tij A.K.,. Nga kjo bisedë u vërejt, se fëmija ishte i stresuar, nuk donte të fliste për këtë ngjarje, thjesht donte që kjo situatë të përfundonte, të mbaronte vitin shkollor dhe preferonte, që mësuese Lindita Kapollari të mos i jepte më mësim në vitin e tretë. Fëmija nuk pranoi që shkaktoi të dy incidentet të ishte ai. Në rastin e parë pretendoi, se nuk i ka patur duart në “xhepa”, por jashtë tyre dhe se mësuesja i ka kërkuar që duart ti vendosë mbrapa dhe djali ka refuzuar. Situata që pason, çfarë ka ndodhur është e njohur. Incidenti tjetër ka ndodhur te dera e klasës, pasi kanë dalë praktikantët dhe nxënësi ka qenë te dera. Pretendimi i tij është, që zysha e ka shtyrë për të kaluar dhe duke bërë titur i ka thënë “...jam unë këtu...”.

Pyetjes se si janë marrëdhëniet e tij me mësuesen tani, ai i është përgjigjur se pas incidenteve, mësuesja nuk e ka ngritur më në mësim, janë bërë mini-teste dhe ka dalë dobët. Do të regjistrohet për të ndjekur një kurs fizike, për t’u përpjekur që të kalojë klasën.

Prindi i fëmijës u shpreh se, nga ngarkesa psikologjike që ka patur fëmija dhe ndryshimi në sjellje (ai u mbyll në vetvete, la palestrën etj) dhe, si pasojë e gjithë kësaj situatë, është detyruar të çojë për konsultim në psikolog privat djalin, pasi shkolla nuk ka patur psikolog në atë periudhë kohe. Sipas pretendimeve të prindit, mësuesja komunikoi me terma jo-korrekt dhe brenda etikës. Kur është paraqitur në shkollë ta takojë, mësuesja i ka thënë, se këtë vit djali nuk do ta ketë ndihmën e saj, siç e ka patur një vit më parë. Ai është shprehur se nuk kërkon favore apo notën nga mësuesja, thjesht kërkon që të mos ushtrojë presion psikologjik tek fëmija dhe të ketë një komunikim normal me të. Pyetjes së ndihmëskomisionereve për ecurinë e djalit në këtë lëndë, babai i’u përgjigj se në mbledhjet

me prindërit, nga mësuesja kujdestare nuk i janë dhënë notat e fizikës, por e di që djali nuk është mirë në këtë lëndë.

Nisur nga sa më sipër vërehet se fëmijët, nxënës të Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Partizani”, ndihen nën presion psikologjik, të shkakuar nga rrethanat në të cilat ka precipituar kjo ngjarje. Ky konkluzion u arrit nga një sërë provash dhe faktesh të mbledhura nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë hetimit të pavarur administrativ, intervistat e realizuara me prindrit dhe fëmijët e kësaj shkolle të përfshirë në ngjarjet e ndodhura, konkluzionet e nxjerra nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe konkluzionet e pyetësorëve të zhvilluar nga psikologia e shkollës.

Faktet dhe provat e sipërpërmendura shprehin qartë mosrespektimin e dispozitave ligjore të parashikuara në pikën 3, të nenit 3 të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku dhunë ndaj fëmijës është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi. Gjithashtu, vërehet se nuk është respektuar edhe pika 5, të nenit 18 e po këtij ligji ku gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës, gjatë procesit të edukimit, janë të ndaluara.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 18 e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, gjykon, se krijimi i kushteve të përshtatshme për edukimin dhe shkollimin e nxënësve në shkolla, është përgjegjësi e një trekëndëshi institucional, të përbërë nga prindërit, shkolla nëpërmjet mësuesve dhe vetë fëmijëve.

Mirëfunksionimi i të gjitha hallkave zinxhir të këtij sistemi, do të bënte të mundur garantimin e parimit të gëzimit të një fëmijërie të qetë nga fëmijët, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, si dhe parimit të dëgjimit të mendimit të fëmijës, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, në zbatim edhe të neneve 3, 9, 12 e 13 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

### **Konkluzione:**

Avokati i Popullit, nisur nga tërësia e fakteve, provave shkresore të depozituara për çështjen, hetimit të pavarur administrativ që realizoi, konstatoi se:

1. Fëmijët, nxënës të shkollës së mesme të përgjithshme “Partizani”, janë vendosur në një presion psikologjik në vazhdimësi si rezultat i zgjatjes së procesit të ankimimit nga të dyja palët, kontrolleve dhe monitorimeve të vazhdueshme nga Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, Inspektorati Shtetëror Arsimor dhe institucioni i Avokatit të Popullit.
2. Gjithashtu, vërehet se është cënuar marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, si dhe besimi i palëve në zbatimin e të gjitha dispozitave të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të kontratës së punës, pasi nga bisedat me palët del e qartë mosbesimi në thëniet, veprimet e ndryshme procedurale të ndërmarra nga të dyja palët.

Në mënyrë që edukimi i fëmijëve të kryhet në një mjedis të qetë duke garantuar të drejtën e tyre për t’u arsimuar, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të neneve 18

e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës si dhe ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, kërkohet nga institucionet përgjegjëse ndërmarrja e hapave ligjore e procedural që raste të tilla të parandalohen në kohë, minimizohen e të mos përsëriten më.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

Ndaj, referuar parashtrimin të mësipërm, për çështjen në fjalë,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për emërimin përfundimtar të një psikologu për të ofruar një shërbim sa më të plotë psiko-social, në shkollën e mesme të përgjithshme “Partizani”, Tiranë.
2. Marrjen e masave për transferimin e mësueses së fizikës, znj. Lindita Kapollari, në një shkollë të mesme të përgjithshme tjetër, në qytetin e Tiranës, në përfundim të këtij viti shkollor.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit.

Për, sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve,

**AVOKAT I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**